VENDIM
Nr.301, datë 13.4.2010

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin "Rregullat për prokurimin publik", që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në shkronjën "a", pas nënndarjes "I" të pikës 1 të kreut II "Rregullat e përgjithshme të prokurimit", shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht, për Autoritetin Kombëtar Rrugor, vlera e kufirit për kontratat e punëve publike të jetë sa dyfishi i vlerës së mësipërme të kufirit të përcaktuar për të gjitha entet e tjera.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha